

URDHËR
Nr. 1133, datë 26.7.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të neneve 28, 29, dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mbrojtjes, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, znj. Gelardina Prodani.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
 3. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
 4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
 5. Urdhri nr. 1009, datë 28.6.2022, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR IMBROJTJES
Niko Peleshi